EMBASSY OF THE UNITED STATES
SKOPJE • MACEDONIA

Ambasadori uron Ditën e alfabetit

Me rastin e Ditës së alfabetit të gjuhës shqipe, 22 nëntori, ambasadori Wohlers vizitoi Institutin e trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqipëtarëve "Pjetër Bogdani" në Shkup ku u mirëprit nga drejtori, prof. Shefqet Zekolli. Ata diskutuan për tema që kanë të bëjnë me historinë dhe kulturën shqipëtare dhe gjuhën shqipe, por njëkohësisht shqyrtuan edhe mundësitë për të vazhduar bashkëpunimin mes Ambasadës dhe Institutit. Ambasadori shfrytëzoi rastin që të gjithë shqipfolësve t'ua urojë Ditën e alfabetit të gjuhës shqipe.